



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.10, nenin 74 paragrafi 11, nenin 77 dhe nenin 79 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, neni 12 paragrafi 8 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, si dhe vendimin e KQZ-së, Nr.01/192-2025, të datës 21.01.2025, për Miratimin e Përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve në Vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datë 04.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në Vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike

- I. Emërohen Këshillat e Vendvotimeve (KVV) në vendvotimet të përfaqësive diplomatike, të propozuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen në Përfaqësi Diplomatike më 08 shkurt 2025.
- II. Regjistri i anëtarëve të KVV-ve si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.02.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2, nenin 101 paragrafi 14 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.16/2024 Qendra Komonale e Numërimit, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datë 04.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Procedurave të Numërimit në Qendrën Komonale të Numërimit

- I. Miratohen Procedurat e Numërimit në Qendrën Komonale të Numërimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.
- II. Procedurat si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.02.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2, të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datë 04.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave Teknike për Sistemin e Alarmit Konvencional në QNR

- I. Miratohen specifikat teknike për sistemin e alarmit konvencional në QNR.
- II. Specifikat si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.02.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2, të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datë 04.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Specifikave Teknike për Sistemin e Rrymës në QNR

- I. Miratohen specifikat teknike për sistemin e rrymës në QNR.
- II. Specifikat si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 04.02.2025

